




Agricultural University of Tirana



MARRËVESHJE
MBI
BASHKËPUNIMIN ARSIMOR - SHKENCOR
MIDIS
UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" (VLORE – SHQIPËRI)
DHE
UNIVERSITETIT BUJQËSOR TË TIRANËS (TIRANË – SHQIPËRI)

OBJEKTI I MARRËVESHJES

Universiteti Bujqësor i Tiranës i përfaqësuar nga Prof. Dr. Bari Musabelliu, Rektor dhe Universiteti "Ismael Qemali" Vlorë i përfaqësuar nga Prof. Dr. Roland Zisi Rektor, për efekt të nënshkrimit të marrëveshjes së mëposhtme paraqiten si palë.

BAZA LIGJORE

Mbështetur në Ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007 (i ndryshuar), "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë dhe Statuteve perkatese te dy universiteteve, palet shprehin vullnetin e përbashkët dhe bien dakord të vendosin marrëdhënie bashkëpunimi në fushën e arsimit dhe punës kërkimore shkencore midis të dy universiteteve duke synuar rritjen dhe plotësimin e rolit të pazevendësueshëm të të dy institucioneve tona akademike e shkencore për zhvillimin dhe prosperitetin e vendit. Ky bashkëpunim do të ndikojë në plotësimin e nevojave për zhvillimin e arsimit dhe shkencës në të dy institucionet duke informuar më mirë njëri-tjetrin në zbatim të kriterëve akademike të unifikuara në shkencë dhe edukim në vendet evropiane dhe me gjere.

NENI 1

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është të institucionalizojë bashkëpunimin ndërmjet dy institucioneve tona në nivele të ndryshme.

NENI 2

Me qellim që kjo marrëveshje të funksionojë, të dy palët do të respektojnë dhe do të zbatojnë të gjitha procedurat dhe do të shfrytëzojnë të gjitha mekanizmat e nevojshme dhe ligjore për bashkëpunim.

PJESA I



Pjesëmarrja në programet e Bashkimit Evropian (ERASMUS, TEMPUS, TACIS, etj) gjithashtu formojnë një pjesë të bashkëpunimit arsimor dypalësh.

NENI 7

Palët angazhohen që, për nevoja të procesit mësimor, të organizojnë shkëmbime të stafit akademik me kusht që kjo të mos sjellë vështirësi për vijueshmërinë normale të këtij procesi në institucionin e origjinës.

NENI 8

Të dyja palët bien dakord për të zhvilluar kushtet e kërkuara për njohjen reciproke të programeve mësimore dhe të Diplomave të Arsimit të Lartë (Diplomat për Bachelor, Master Profesional e Master i Shkencave etj).

PJESA II

BASHKËPUNIMI SHKENCOR

NENI 9

Të dyja palët e konsiderojnë racionale mundësinë e njohjes reciproke të arritjeve në të dy universitetet dhe angazhohen të vendosin kontakte krijuese në fusha të interesit të ndërsjellte.

NENI 10

Të dyja palët bien dakord për të nxitur shkëmbimet krijuese midis tyre me anë të vizitave dhe punës shkencore në Institucionin e Arsimit të Lartë (laboratorëve të kërkimit shkencor, bibliotekave, fakulteteve, departamenteve).

NENI 11

Palët angazhohen, që në periudha të caktuara të organizojnë simpoziume shkencore të përbashkëta me arritjet më të mira duke parë me përparësi temat e përbashkëta.

NENI 12

Palët mirkuptohen për organizimin e seminareve të përbashkëta me studentët dhe stafin akademik në formën e shkëmbimit të ideve.



PËRFUNDIMTARE

NENI 18

Marreveshja hyn në fuqi nga momenti i nënshkrimit nga palët dhe është me afat kohor të pacaktuar.

NENI 19

Ndryshimet, përmirësimet apo anulimi i kësaj marrëveshjeje bëhet me propozimimn dhe pëlqimin e palëve. Në çdo rast palët njoftohen reciprokisht me shkrim jo më pak se 6 muaj përpara.

Marrëveshja nënshkruhet nga:

Për:

Universitetin Bujqësor I Tiranës

Rektori

Prof. Dr. Bari Musabelliu

Datë

Universiteti Bujqësor i Tiranës
Kodër-Kamëz
Tirana
SHQIPËRI
TELEFON + 355 4 200 873
FAX + 355 4 200 874
E-mail: _____@ubt.edu.al
<http://www.ubt.edu.al>

Për:

Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë

Rektori

Prof. Dr. Roland Zisi

Datë

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë
Vlorë, Shqipëri
Telefon: +355 33 222288
Email: info@univlora.edu.al
<https://univlora.edu.al/>

